



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 420/6 Prot.

Tiranë, më 20.9.2024

V E N D I M

Nr.51, datë 20.9.2024

Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me vlerësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, të kryer në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, të ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të procesit të inspektimit të nisur me Urdhër nr. 72, (nr.420 prot.), datë 8.7.2024, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe neneve 2 dhe 14, germa a), neneve 16 dhe 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, si dhe nisur nga informacionet që ka administruar për kryerjen e veprimeve administrative në kundërshtim me ligjin, nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra specifike të administrimit të shërbimit civil gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, me urdhrin nr. 72, (nr.420 prot.), datë 8.7.2024 “Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz”, ka vendosur fillimin e inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera gjatë zhvillimit të procedurave disiplinore, në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

Gjatë këtij procesi inspektimi, grupi i punës, me anë të procesverbalit të datës 22.7.2024, “Procesverbal për marrjen në dorëzim të dokumentacionit pranë Bashkisë

Fushë-Arrëz” dhe procesverbalit të datës 24.7.2024 “*Procesverbal për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të administruar gjatë ecurisë disiplinore, në ngarkim të nëpunëses ******”, administroi pranë institucionit aktet administrative, në të cilat dokumentohen veprimet e kryera gjatë administrimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për punonjësen *****, me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Sociale*”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit dhe në dosjen në të cilën materializohet ecuria disiplinore në ngarkim të nëpunëses, të depozituara pranë zyrës së njesisë përgjegjëse, rezulton se nëpunësja në fjalë, fillimisht e ka filluar marrëdhënien e punës pranë këtij institucionin me urdhrin nr. 87, datë 08.03.2021, “*Për emërim në punë*”, të Kryetarit, në pozicionin “*Koordinatorë e Dhunës në Familje*”.

Më pas, me anë të Urdhrit nr. 458, datë 13.12.2021 “*Për ndryshim pozicioni*”, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse në Sektorin e Çështjeve Sociale*”, rezulton se, në dosjen e personelit të kësaj punonjëse nuk është administruar asnjë akt, i cili mund të vërtetojë zhvillimin e procedurës së konkurrimit, për emërimin e punonjëses në këto pozicione pune.

Për këtë qëllim, me e-mailin e datës 24.7.2024 punonjëses ju kërkua nëse disponon akte të cilat provojnë se emërimi i saj në shërbimin civil, është kryer përmes një procedure të rregullt konkurrimi, të na i vinte në dispozicion, me qëllim hetimin e plotë të rastit. Nga ana e kësaj punonjëse, nuk është kthyer asnjë përgjigje.

Në këto kushte, rezulton se, emërimi i punonjëses *****, në pozicionin “*Koordinatorë e Dhunës në Familje*” dhe më pas, në pozicionin “*Përgjegjëse në Sektorin e Çështjeve Sociale*”, është kryer në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të përcaktuara në nenet 23, 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese*”, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të cilit institucionet e vetëqeverisjes vendore i referohen për analogji.

Këto dispozita përcaktojnë se, çdo emërim në një pozicion të shërbimit civil, duhet të kryhet përmes një procedure të rregullt konkurrimi, dhe se emërimi i kryer në kundërshtim me përmbajtjen e tyre, është **absolutisht i pavlefshëm**.

Në lidhje me emërimin në pozicione të nivelit të ulët drejtues, legjislatori ka parashikuar kërkesa dhe rregulla të hollësishme procedurale, në nenin 26 të ligjit për nëpunësin civil,

duke respektuar parimet për pranimin në shërbimin civil që janë: parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësisë profesionale e mosdiskriminimit të nëpunësit civil me qëllim që pranimi në shërbimin civil të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë.

Procesi përzgjedhës duhet të zhvillohet fillimisht nëpërmjet lëvizjes paralele të nëpunësve civilë që e gëzojnë statusin në kategorinë paraardhëse, e më tej nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike.

Në këto rrethana, duke qenë se, emërimi i punonjës ***** në pozicionin “Përgjegjëse në Sektorin e Çështjeve Sociale”, është kryer pa një procedurë të rregullt rekrutimi, atëherë kjo punonjëse, nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, e si rrjedhojë çdo veprim i mëtejshëm që ka lidhje me marrëdhënien e saj të punësimit nuk mund të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Për më tepër, nga dokumentacioni i administruar në dosjen personale të punonjësës, vërtetohet se, ajo disponon diplomë “Bachelor”, në profilin “Punë Sociale”, nr. 1175, me datë lëshimi 25.01.2021, si dhe diplomën “Master Profesional”, në profilin “Punë Sociale në Arsim”, nr. 2971, me datë lëshimi 03.02.2022, me 60 kredite.

Kjo provon përsëri faktin se, emërimi i kësaj punonjëse është në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, pasi në mbështetje të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe bazuar në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar me vendimin nr. 765, datë 26.12.2018, ku në pjesën “Kërkesa të Posaçme”, për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, kërkohet niveli arsimor, “Master shkencor apo Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, kriter i veçantë, të cilin punonësja nuk e plotëson, edhe në rast se procedura e emërimit në këtë pozicion të shërbimit civil do të ishte e rregullt, me konkurrim.

Në lidhje me sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, me nxjerrjen e aktit nr. 122, datë 18.3.2024 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjës ***** , ka rikthyer situatën e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pasi në zbatim të nenit 110 dhe 111 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, sanksionohet se, aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin, janë të pavlefshme, si rrjedhim është detyrim i vetë organit publik që i ka nxjerrë këto akte, të konstatojë pavlefshmërinë e tyre, duke anuluar pasojat e ardhura.

✓ Sa i takon masave të tjera disiplinore nga përfaqësuesja e njësisë përgjegjëse, grupi i punës u informua se ka pasur një ecuri disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në vitin

2022, për punonjësen ******, me detyrë “*Specialiste e Turizmit*”, vendim i cili është ankimuar në gjykatë dhe ka marrë formë të prerë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Disiplinës.

Në këto rrethana, nuk janë konstatuar parregullësi në administrimin e shërbimit civil nga ana e organeve të ngarkuara me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, e për këtë arsye duhet të përmbillet procesi i inspektimit pa vendim paralajmërimi.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, të nenit 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” si dhe në mbështetje të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të përfundojë hetimi administrativ i nisur me urdhrin e inspektimit nr. 72, (nr.420 prot.), datë 8.7.2024 “*Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në institucionin e Bashkisë Fushë-Arrëz*” të Komisionerit, pa vendim paralajmërimi, pasi gjatë këtij procesi nuk u konstatuan parregullsi në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Fushë-Arrëz dhe njësia përgjegjëse të njoftojë punonjësen ******, për përfundimin e këtij procesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha